

Mitropoliti i Apollonisë & Fierit: 'Le të forcojmë lutjet tona për shërimin e qindra mijëra të sëmurëve dhe të infektuarve nga virusi'



Të dashur besimtarë,

Uroj që ju dhe të gjithë të afërmit tuaj të jeni mirë në këtë situatë të vështirë që po kalon vendi ynë dhe shumë popuj të tjerë në mbarë botën, për shkak të pandemisë së Covid-19!

Këto ditë të karantinës kemi parë se po privohemi nga shumë gjëra dhe zakone të përditshme të jetës sonë edhe për më tepër, nga jeta adhuruese në Kishë dhe Kungimi i Shenjtë. Kuptoj shumë mirë vuajtjen dhe dhimbjen tuaj. Dhimbja juaj është dhe dhimbja ime, vuajtja juaj është dhe vuajtja ime!

Pavarsisht këtyre privimeve të shumta, kjo situatë është rast dhe mundësi e mirë për të menduar, vlerësuar dhe reflektuar mbi shumë gjëra, të cilat nuk na i ka mundësuar rutina e përditëshme:

- Të shijmë jetën familjare me prindrit, fëmijët dhe bashkëshorten ose bashkëshortin.

- Të shqyrtojmë marrëdhënien tonë me Zotin e besimin si edhe miqesinë tonë me të afërmit e të gjithë njerëzit e tjerë.
- Të vlerësojmë dhuratën e madhe të jetës dhe pjesëmarrjen në jetën mistike të Kishës.
- Të bëjmë përgatitjen tonë, sado e dhimbshme të duket, nëse Zoti do të na thërrasë pranë Tij.

Ju falënderoj që përpiqeni të zbatoni masat e marra nga organet kopetente shtetërore!

Ju falënderoj që keni mirëkuptuar njoftimet zyrtare të Sinodit të Shënjtë të Kishës sonë në lidhje me këtë situatë pandemike, pavarësisht disa reagimeve “të zellshme”! Lëvizjet dhe masat që po meren nga shtetet e tjera, shumë më të fuqishme se vendi ynë, drejtësojnë veprimet e marra nga Shteti Shqiptar.

Masat parandaluese që ndërmorën Kishat e tjera simotra në mbarë botën, tregojnë mjaft qartë, maturinë e veprimeve të Kishës sonë.

Këmbëngulja në pjesëmarrjen e shërbesave të shenjta dhe në Falenderimin Hyjnor, në këtë situatë, do të ishte një qëndrim egoist, (sepse është një përpjekje për të përmbushur nevojat personale duke harruar të afërmin), ndërsa privimi ynë nga Shërbesat dhe madje edhe nga Kungimi Hyjnor, në këtë rast, është një shenjë e sakrificës dhe dashurisë për të afërmin dhe vëllain tonë.

Dhe pikërisht këtë na mëson edhe vetë Shpëtimtari ynë Jisu Krisht; të sakrifikojmë gjithçka, akoma edhe jetën tonë nëse do të nevojitet, për dobinë e të afërmit tonë. “Askush s’ka dashuri më të madhe se kjo, të vërë ndonjë jetën e tij për miqtë e tij” (Joani 15:13).

Theksojmë se, ky privim nuk është për shkak të frikës a mohimit të besës, por është një tregues i dashurisë sakrifikuese për njerëzit tanë të afërt edhe të largët.

E vërteta është se kjo situatë nuk na privon krejtësisht nga shërbesat, ato mund t’i kryejmë në shtëpi me të gjithë pjesëtarët e tjerë të familjes, ose për ata që nuk e kanë mundësinë, le t’i ndjekin ato në internet, në faqen zyrtare të Kishës apo në “Radio Ngjallja”.

Mjaftojnë, të dashur besimtarë, vështirësitë që kemi me përhapjen e virusit. Le të mos i shtojmë më tepër plagë shoqërisë dhe Kishës së Krishtit. Përkundrazi,

- le të forcojmë lutjen tonë te “Zoti i madh i fuqive”, që të zgjasë dorën e Tij njeridashëse për ta ndaluar këtë pandemi,
- le të forcojmë lutjet tona që shkenctarët të gjejnë kurën dhe vaksinën e duhur,
- le të forcojmë lutjet për heronjtë e kësaj situatë, stafin mjekësor dhe për ata që janë të angazhuar në shërbime të ndryshme,
- le të forcojmë lutjet tona për shërimin e qindra mijëra të sëmurëve dhe të

infektuarve nga virusi,

- le të lutemi që Zoti të prehë në paqe ata që kanë ndërruar jetë dhe t'ju japë ngushëllim të afërmeve të tyre dhe,
- le të lutemi që Zoti të ndriçojë qeveritarët dhe menaxhuesit, për vendimarrje të duhura.

Le të kemi besim se me ndihmën e Perëndisë do ta përballojmë dhe do ta kalojmë këtë situatë. Kurajo të dashur besimtarë, nuk do të na braktisë Zoti!

Gjej rastin të falënderoj të gjithë ata besimtarë që iu bashkuan korit të klerikëve në kryerjen e shërbesës së Paraklisit gjatë gjithë orëve të ditës.

Me dashurinë e Krishtit,
Mitropoliti i Apollonisë & Fierit,
† Nikolla

— facebook.com/MitropoliaFier